



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2472/ 12 prot.

Datë 31/10/2024

V E N D I M
Nr. 1541/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshmik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31/10/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Rroku Guest*” SHPK & “*Deha 2010*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike*”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “*Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)*”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Ndertuesi 2014*”

SHPK & “*Varaku E*” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Rroku Guest*” SHPK & “*Deha 2010*” SHPK me NIPT K87921701H dhe L03425410B, me adresë: *Rruga “Hasan Riza Pasha”, Shkodër.*

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rugor Shqiptar.
Adresa: Rruga “Sami Frashëri” Nr.33, Tiranë.

Subjekti i interesuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Ndertuesi 2014*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK me NIPT L46827004L dhe J61902509S me adresë: *Rruga “Daut Boriçi”, Shkodër.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.06.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rugor Shqiptar.

II.2. Në datë 29.07.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit), ku kanë shfaqur interes operatorët ekonomik si mëposhtë vijon:

- 1- BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK.
- 2- BOE “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 29.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit si më poshtë vijon: :

- 1- BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK skualifikuar
- 2- BOE “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK kualifikuar

II.4. Në datën 29.08.2024, bashkimi i operatorëve ekonomik “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave në fazën e parë të shprehjes së interesit, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Rroku GUEST & DEHA 2010” K87921701H L03425410B Skualifikohet, pasi nuk përmbush, kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

- Operatori ekonomik “Rroku GUEST” nuk përmbush kriterin 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Topograf

1 (një) Inxhinier Mekanik

Për secilin pjesëtar të stafit ndihmes të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Staf i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese. KVO gjatë kontrollit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Rroku GUEST” konstaton se, në dokumentat e paraqitura për Ing. Mekanik ka pasaktësi. Nisur nga ky konstatim KVO bëri verifikime dhe rezultoi se Inxhinieri Mekanik i deklaruar nga Operatori ekonomik “Rroku GUEST” është i punësuar në Institucion shtetëror me kohë të plotë.

Operatori ekonomik “Rroku GUEST” në dokumentacionin e paraqitur për Borëpastruesen AJMT60, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se borëpastruesja nuk është APV sipas kërkesës në DST.

Operatori ekonomik “Rroku GUEST” në dokumentacionin e paraqitur për Autobot uji, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se në lejen e qarkullimit është rimorkio për transport mallrash, foto e paraqitur nuk tregon që është Autobot Uji.

II.5. Në datën 04.09.2024, nëpërmejt sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është dorëzuar ankesa me nr. A/2023/4520 dhe me nr. 2472/2024 prot, datë 04.09.2024, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK me pretendimet si më poshtë vijon:

Saj përket pikës së parë ku “Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Rroku GUEST & DEHA 2010” K87921701H & L03425410B Skualifikohet, pasi nuk përmbush, kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit. -Operatori ekonomik “Rroku GUEST” nuk përmbush kriterin 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë), si më poshtë: 1 (një) Inxhinier Topograf 1 (një) Inxhinier Mekanik Për secilin

pjesëtar të stafit ndihmes të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese. KVO gjatë kontrollit të dokumentacionit të parqitur nga operatori ekonomik “Rroku GUEST” konstaton se, në dokumentat e paraqitura për Ing. Mekanik ka pasaktësi. Nisur nga ky konstatim KVO bëri verifikime dhe rezultoi se Inxhinieri Mekanik i deklaruar nga Operatori ekonomik “Rroku GUEST” është i punësuar në Institucion shtetëror me kohë te plotë.” Theksojmë që vendimi i K.V.O. për skualifikimin e B.O.E “Rroku GUEST” sh.p.k. & “DEHA 2010” sh.p.k. në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e kapacitetit teknik për disa arsye:

Së pari, inxhinieri mekanik i deklaruar në këtë procedurë nuk është kërkuar si drejtues teknik, por si staf, ku nëse procedura do fitohet nga B.O.E, do jetë në dispozicion dhe i angazhuar për këtë kontratë. (Inxhinieri i deklaruar si inxhinier mekanik nuk është në licencën e shoqërisë “Rroku GUEST” sh.p.k).

Së dyti, inxhinieri i deklaruar nuk bie ndesh me asnjë legjislacion në fuqi për faktin që mund të jetë i dypunësuar, pasi nuk është drejtues teknik në asnjë kompani në Republikën e Shqipërisë. Ne si B.O.E kemi konkuruar në një procedurë shërbimi dhe duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, V.K.M për rregullar e prokurimit publik, kriteret e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, kodin e punës dhe legjislacionin përkatës për punimet e zbatimit në ndërtim. Me sa është verifikuar nga B.O.E B.O.E “Rroku GUEST” sh.p.k. & “DEHA 2010” sh.p.k. Ne nuk kemi rënë ndesh me asnjë dispozite ligjore qofte të prokurimit publik, as të legjislacionit të punimeve të zbatimit ku citohet vetëm detyrimi që drejtuesit teknik nuk mund të angazhohen në asnjë punë marrje tjetër në momentin që bëhen drejtues teknik i një shoqërie. Nuk kemi shkelur as kriterin e veçantë të shkruar nga autoriteti kontraktor (i cili trajtohet dhe me poshtë) apo nuk kemi rënë ndesh me Kodin e Punës për lejimin e dy punësimit.

Së treti, Në kriterin e vendosur në D.S.T si vijon: “Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.” kemi të bëjmë me një fjali, në të cilën lidhëza “apo” është lidhëz bashkërenditëse veçuese, e klasifikuar kështu sipas funksionit sintaksor që kryen në fjali (marrë nga libri “Gramatika e Gjuhës Shqipe 1”, botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë / Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Kreu X, pika 10.2.3.1.b “Klasifikimi i lidhëzave sipas funksionit”, faqja 406), mirëpo kjo lidhëz përdoret në pyetje kur është fjala për zgjedhje midis objekteve, veprimesh, tiparësh, rrethanash të kundërta, të kundërvëna a të ndryshme (marrë nga libri “Gramatika e Gjuhës Shqipe 2”, botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë / Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Kreu XV, pika 2.2.2.1 paragrafi 5, faqja 304). Kjo do të thotë se nuk kemi të bëjmë me zgjedhje midis “...kontrata të tjera...” dhe “...të deklaruar në procedura të shpallura fituese...” , prandaj kjo lidhëz i jep kuptim gjithë këtij togfjalëshi si

një e vetme, jo si e ndarë ku një pjesë flet për kontratat në tërësi dhe pjesa tjetër për kontratat e prokurimit publik të shpallura fituese, sepse kjo na perjashtohet që nga fakti që nuk kemi të bëjmë me një fjalë pyetëse, por me një fjalë dëftore. Në këtë kuptim ky kriter tregon për angazhimin në kontratat e prokurimit publik (në proces apo në kontrata të shpallura fituese) dhe jo në kontratat e punës që një anëtar stafi i një kompanie mund të ketë.

Së katërti, referuar edhe procesverbalit të argumentimit të publikuar në S.P.E nuk ka asnjë argumentim në lidhje me pikën “Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.” që t’i japi ndonjë indicie operatorëve ekonomikë që ky kriter bën fjalë për angazhim në punëmarrje të cfarëdoshme, por ky kriter i referohet vetëm angazhimit në procedurat në vazhdim apo të shpallura fituese (ku jo rrallë herë një kompani shpallet fituese, por për shkaqe nga më të ndryshme shtyhet fillimi i punimeve) me Autoritetet Kontraktore në kuptimin e prokurimit publik. Në D.S.T nuk është kërkuar që stafi i deklaruar nuk duhet të jetë i angazhuar në asnjë punëmarrje tjetër. Për këtë arsye K.V.O nuk ka zbatuar kriterin sipas kërkesës së D.S.T, por e ka interpretuar kriterin jashtë kompetencave që i jep legjislacioni i prokurimit publik. Për sa më sipër kërkojmë rishikim të këtij argumentimi duke e rrëzuar atë dhe duke kualifikuar ofertën tonë, pasi mendojmë që arsyetimi që K.V.O i ka dhënë këtij skualifikimi nuk qëndron.

Gjithashtu, duke marrë shkas nga ky interpretim e nga kontrolli që është prezantuar dhe konstatuar nga K.V.O. besojmë që i gjithë ky proces është i dokumentuar me shkresat përkatëse dhe gjithashtu duke patur parasysh nenin 2 të ligjit Nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, pika d, Autoritetet duhet “...të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”, besojmë që ky kontroll është bërë edhe për operatorin tjetër konkurues në këtë procedurë prokurimi si dhe për operatorët e tjerë (pa dallim) që kanë konkuruar në procedurën “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër me numër njoftimi CN/1094562/25062024 si dhe numer reference REF-10941- 06-24-2024”.

Saj përket pikës së dytë “Operatori ekonomik “Rroku GUEST” në dokumentacionin e paraqitur për Borëpastruesen AJMT60, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se borëpastruesja nuk është APV sipas kërkesës në DST” duhet theksuar që ky argument nuk qëndron, pasi në dokumentacionin e paraqitur Certifikatë e Pronësisë së mjetit Rrugor tek të dhënat mbi identifikimin dhe karakteristikat teknike të mjetit “lloji” jepet e shkruar “MAKINË TEKNOLOGJIKE PËR ZHBLLOKIM RRUGE” gjithashtu në lejen e qarkullimit të mjetit pika 1 “lloji” theksohet që kjo është “MAKINË TEKNOLOGJIKE PËR ZHBLLOKIM RRUGE” . Kjo vertetohet edhe me fotot përkatëse ku mjeti ka rruspën për të pastruar borën që zhbllokton rrugën si edhe shpërndarësen e kripës të cilat janë kërkuar në DST. Bashkëlidhur këtij ankimimi do gjeni edhe dokumentacionin e plotë të mjetit në fjalë. Për sa më sipër kërkojmë rishikim të këtij argumentimi duke e rrëzuar atë dhe duke kualifikuar ofertën tonë, pasi mendojmë që arsyetimi që K.V.O i ka dhënë këtij skualifikimi nuk qëndron.

Saj përket pikës së tretë “Operatori ekonomik “Rroku GUEST” në dokumentacionin e paraqitur për Autobot uji, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se në lejen e qarkullimit është rimorkio për transport mallrash, foto e paraqitur nuk tregon që është Autobot Uji.” Sërish kemi të bëjmë me një vlerësim jo të saktë nga K.V.O pasi në dokumentacionin e paraqitur certifikatë pronësie tek të dhënat mbi identifikimin dhe karakteristikat teknike të mjetit tek pika “kodi i karrocerisë” shkruhet kodi “K.A. – MJET PËR LAGJEN E RRUGËVE” ndërkohë K.V.O ka shikuar tek të dhënat e rimorkios dhe ka parë të shënuar rimorkio për transport mallrash. Duam t’ju informojmë se në lejen e qarkullimit të cdo mjeti, edhe të autoveturave mund të vendosësh rimorkio e cila lidhet me automjetin në fjalë. Që ajo rimorkio të jetë e ligjshme për të dalë në qarkullim duhet të marrë targa dhe të futet në lejen e qarkullimit të automjetit që do i vendoset rimorkio. Pra ajo çfarë K.V.O ka zbuluar në këtë rast nga verifikimi nuk ka qënë që mjeti nuk është autobot uji sic e kemi vetdeklaruar, por që ky mjet ka edhe një rimorkio që sipas nevojave të kompanisë mund t’i vendoset këtij mjeti. Fakti që ky mjet ka të dhëna për rimorkion, pra që ka edhe një pajisje shtesë që mund t’i vendoset, nuk e zhbën faktin që mjeti është autobot sipas kodit të karrocerisë. Në këtë rast kompania ka zbatuar kodin e qarkullimit rrugor. Për sa më sipër kërkojmë rishikim të këtij argumentimi duke e rrëzuar atë dhe duke kualifikuar ofertën tonë, pasi mendojmë që arsyetimi që K.V.O i ka dhënë këtij skualifikimi nuk qëndron. Bashkëlidhur ne do i dërgojmë Komisionit të Prokurimit Publik të gjithë dokumentacionin shoqërues të mjetit që verteton pretendimet tona.

Duke patur autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën përshprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji” vlerësojmë që kualifikimi BOE “NDERTUESI 2014” shpk & “VARAKU E” sh.p.k është i pasaktë dhe se ky bashkim operatorësh ekonomik duhet skualifikuar pasi nuk ka plotësuar ofertën në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në D.S.T.

Gjithashtu Referuar edhe Procesverbalit Nr. 2, Datë 20.08.2024 mbi vlerësimin e ofertave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar (procesverbali do i bashkengjitet kërkesës) ku Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Rroku GUEST & DEHA 2010” K87921701H L03425410B Skualifikohet, pasi nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit. Operatori Ekonomik “Rroku GUEST” sh.p.k nuk përmbush kriteret kumulative referuar nën-pikës 2.2.1 e seksionit 2.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit. “Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk

plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.” Referuar vërtetimit për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të deklaruara nga OE “Rroku GUEST”, ku vlera më e lartë e xhiros është viti 2023 me të ardhura 189,125,479 dhe kriteret të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit “Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (nënpika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriteret të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike, nënpika 2.3.1; 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5; 2.3.7 dhe 2.3.9 të kriteret të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriteret kumulative për Lotin konkret.”, ku vlera e llogaritur që duhet të plotësojë operatori ekonomik duke marrë në konsideratë % e bashkëpunimit si dhe vlerën e fondit limit për lotet e përmendur në deklaratën kumulative është 272,773,161.10. Kriteri konsiderohet i përmbushur nga operatori ekonomik.

Gjithashtu referuar edhe Dokumentet Standarde të tenderit tek Njoftimi i Kontratës Pika 2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues: Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t’i jepen një ofertuesi: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (nënpika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriteret të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike, nënpikat 2.3.1; 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5; 2.3.7 dhe 2.3.9 të kriteret të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriteret kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriteret kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar. Në i kemi dërguar kërkesë Autoritetit Kontraktor për të na njoftuar për procedurat ku subjekti konkurues me ne ka ofertuar, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje për këtë kërkesë. Nisur nga kjo ne kemi marrë informacion nga operatorët e tjerë konkurues që OE “NDERTUESI 2014” ka ofertuar në lotet e mëposhtme: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me Nr. Reference REF-10943-06-24-2024 ; Loti 2: Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km) me Nr. Reference REF-10945-06-24-2024 ; Loti 3: Mirëmbajtje me performancë rruga “Harku i Bërdicës - Velipojë (Vilun), Ura (Ere) e Bunës - Shirokë (fillim pedonalja), Baks - Rrjoll, K.Bushat - Bisht Jugë” (gjatësia totale 49.4 me Numër Reference REF-10947-06-24-2024. ; Loti 4: Mirëmbajtje me performancë rruga “D/Qafë Laç - Koman (Trageti), K/Vau i Dejës Nënshat (kufi me Lezhën)” (gjatësia totale 45.3 km) me Numër Reference REF-10949-06-24-2024.

Operatori “NDERTUESI 2014” sh.p.k nuk plotëson pikën 2.2.1, në menyrë kumulative për të gjitha lotet sipas % që ka marrë përsipër në kontratat e bashkëpunimit, gjë që në këtë lot ka dështuar ta plotësojë duke mos paraqitur deklaratë ku ka listuar dokumentet e paraqitura (vertetim xhiro vjetore, dhe deklarate e përmbushjes kumulative per secilin lot) në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret duke e bërë jo legjitime kërkesën për ofertë të këtij BOE në këtë procedure, pra mendojmë qe kjo oferte duhet skualifikuar nga kjo procedurë për mosplotësim të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori “NDERTUESI 2014” sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.1, në menyrë kumulative për të gjitha lotet sipas % që ka marrë përsipër në kontratat e bashkëpunimit sepse do duhej të kishte (sipas procesverbalit të argumentimit të kriterëve) shërbim të ngjashëm mirëmbajtje rutinë 173 044 920.24 lekë pa tvsh në total për të plotësuar në mënyrë kumulative për të gjitha lotet ku ka ofertuar, gjë që në këtë lot ka dështuar ta plotësojë duke mos paraqitur deklaratë ku ka listuar dokumentet e paraqitura (Deklaraten ku paraqet qe ka përmbushur vlerën totale te shërbimit te kerkuar) në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret duke e bërë jo legjitime kërkesën për ofertë të këtij BOE në këtë procedure, pra mendojmë qe kjo oferte duhet skualifikuar nga kjo procedurë për mosplotësim të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori “NDERTUESI 2014” sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.4, në menyrë kumulative për të gjitha lotet sipas % që ka marrë përsipër në kontratat e bashkëpunimit sepse do duhej të plotësonte kriterin: “Kandidati ofertues duhet të disponoje 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, i cili do të jetë Drejtues Teknik i punimeve/shërbimeve, i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet / punimet në objekt.”, duke qënë që ky bashkim operatorësh ka ofertuar në katër lote, pra duhet të ketë 4 inxhinierë ndërtimi në licencë, gjë që këto operatorë nuk e plotësojnë pasi këto kanë vetëm nga një inxhinier ndërtimi në licencë ku duhej të kishin katër inxhinierë , gjë që në këtë lot ka dështuar ta plotësojë duke mos paraqitur deklaratë ku ka listuar dokumentet e paraqitura (stafin teknik, 4 inxhinier ndërtimi drejtues teknik ne licence) në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret duke e bërë jo legjitime kërkesën për ofertë të këtij BOE në këtë procedure, pra mendojmë qe kjo oferte duhet skualifikuar nga kjo procedurë për mosplotësim të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori “NDERTUESI 2014” sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.9 në menyrë kumulative për të gjitha lotet sipas % që ka marrë përsipër në kontratat e bashkëpunimit, pasi janë kërkuar edhe mjetet në mënyrë kumulative si rrjedhojë ky operator ekonomik duhej të plotësonte një deklaratë për plotësimin e këtij numri makinerive sipas loteve ku ka ofertuar, sipas tabelës se mëposhtme(referuar D.S.T, kriteret e veçanta te kualifikimit), gje qe dyshojmë qe nuk e ka paraqitur, sipas kërkesës se DST.

Gjithashtu operatori “NDERTUESI 2014” shpk nuk e ka plotësuar deklaratën ku të listohen dokumentet e paraqitura (makineritë, per secilin lot konkret) në përmbushje të kriterëve

kumulative për Lotin konkret, nuk ka zbatuar kriteret e vendosura në DST për këtë procedurë prokurimi duke e bërë jo legjitime kërkesën për ofertë të këtij BOE në këtë procedure, pra mendojmë qe kjo oferte duhet skualifikuar nga kjo procedurë për mosplotësim të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Për arsyet e parashtuara më lart kërkojmë:

Rivlerësimin e procedurës Loti 2: Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km) me Nr. Reference REF-10945-06-24-2024 duke kualifikuar B.O.E “Rroku GUEST” sh.p.k & “DEHA 2010” sh.p.k dhe skualifikimin e B.O.E. “NDERTUESI 2014” sh.p.k & “VARAKU E” sh.p.k.

II.6. Në datën 04.09.2024, nëpërmejt sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është dorëzuar ankesa me nr. A/2023/4520 dhe me nr. 2472/1 prot, datë 04.09.2024, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK.

II.7. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 2472/3 prot., datë 04.09.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 12472/2024 prot., datë 04.09.2024, dhe kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pretendon se nuk përmbushen nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK.

II.8. Në datën 06.09.2024, nëpërmejt shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik është dorëzuar ankesa me nr. 2472/4 prot, datë 06.09.2024, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK.

II.9. Më datë 09.09.2024, bashkimi i operatori ekonomik “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK ka paraqitur Formularin e Paraqitjes së Argumentave, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 2472/5 prot., datë 09.09.2024.

II.10. Në datën 13.09.2024, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” Shpk & “Deha 2010” Shpk me nr. Aplikimi A/2024/4521, të paraqitur në Autoritetin Kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike” të protokolluar me tonën me nr. 2472/6 prot, datë 13.09.2024, si dhe shkresën me nr. 6747/2 prot., datë 17.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2472/7 prot., datë 20.09.2024 me objekt “Shkresë Përcjellëse”, (ardhur nëpërmjetë shërbimit postar) është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës (nr. 6747/1 prot., datë 13.09.2024), nga verifikimi i të cilit konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, me argumentat si më poshtë vijon:

III. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë ankesë Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave argumenton si më poshtë:

Lidhur me pretendimin e parë mbi mos plotësimin e kriterit në pikën 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor jo domosdoshmerisht në licencë), si më poshtë: 1 (një) Inxhinier Topograf, 1 (një) Inxhinier Mekanik, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas verifikimeve ka rezultuar se Inxhinieri Mekanik i deklaruar nga Operatori Ekonomik “Roku GUEST” është i punësuar në Institucion shtetëror me kohë të plote. Ky qëndrim është konfirmuar edhe në ankesën tuaj duke mos e kundërshtuar këtë fakt.

Për sa më sipër referuar ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (Ndryshuar me ligjet: nr. 8085, datë 13.03.1996; nr. 9125, datë 29.07.2003; nr. 10053, datë 29.12.2008; nr. 136/2015, datë 5.12.2015; nr. 91/2024, datë 26.7.2024), Kohezgjatja Maksimale Javore e Punës, Neni 83 (Ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003).

-Kohezgjatja normale e javës së punës është jo më shumë se 40 orë. Ajo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kontratën kolektive ose në kontratën individuale të punës, do të thotë që ky punonjës edhe pse nuk është drejtues teknik në licencën e shoqërisë, është i punësuar me kohë të plote sipas legjislacionit në fuqi.

Për këtë arsye punonjësi në fjalë nuk ka mundësi fizike që të jetë njëkohësisht në 2 vende pune për të kryer detyrat e tij funksionale sipas pozicionit përkatës që ka në një shoqëri, kompani apo në ndonjë institucion. Në këtë kushtë kryerja e 2 funksioneve në kohë të plote njëkohësisht prane 2 vendeve të ndryshme nuk përmbush mundësinë e ndjekjes së zbatimit të shërbimeve të kësaj kontrate.

Për sa përshtrëhet, operatori ekonomik ankimes nuk ka paraqitur dokumentacion në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, pasi një operator ekonomik vlerësohet për kapacitetet që zoteron në kohën e zhvillimit të një procedure prokurimi.

Per sa me siper, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se pretendimi juaj nuk qendron.

Lidhur me pretendimin mbi dokumentacionin e paraqitur per Borepastruesen AJMT 60, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka konstatuar se nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar fizikisht prane ARRSH, verehet se borepastruesja nuk eshte APV sipas kerkeses ne DST. Ne dokumentat standarte te tenderit ishte percaktuar qarte mjeti qe kerkohet si më poshte:

Borepastruese (APV) me freze + turbine + shnek per pastrim bore me kamion ne dispozicion (Kamion+rruspe+shperndares kripe).

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar nga operatori ekonomik në certifikaten e kontrollit te mjetit apo ne lejen e qarkullimit, nuk eshte cilesuar lloji i mjetit/APV (Automjet per perdorim te veçante) sipas kerkeses se DST.

Lidhur me pretendimin mbi dokumentacionin e paraqitur per Autobot Uji, nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar nga operatori ekonomik konstatohet qe ne lejen e qarkullimit te mjetit me targa AA572FL eshte shenuar Rimorkio per transport mallrash dhe ne certifikaten e pronesise së ketlj mjeti eshte shnuar Mjet per lagjen e rrugeve. Te dyja keto te dhena paraqesin konfuzion dhe pasaktesi. Gjithashtu nga foto e paraqitur per kete mjet nuk konstatohet qe ky mjet eshte Autoboot uji dhe ne materialet e paraqitura ne ankesë nuk eshte paraqitur ndonje foto shtese mbi te cilen mund te konstatohet qarte dhe Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses te gjykoje mbi permbushjen e sakte te ketij kriteri.

Per sa me siper, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se nga materialet e paraqitura ka pasaktesi dhe pretendimi juaj nuk qendron.

Lidhur me pretendimin per skualifikimin nga procedura per mosplotesim te Dokumenteve Standarde te Tenderit te bashkimit te operatoreve ekonomik “NDERTUESI 2014” sh.p.k & “VARAKU E” sh.p.k, argumentojme si me poshte:

Formulari i ankeses i paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Roku GUEST” sh.p.k & “DEHA 2010” sh.p.k, prane Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik, eshte plotesuar per proceduren e prokurimit me objekt: “Loti 2: Mirembajje me performance rruga Koplik - Boge, Boge - Theth, Dedaj – Razem” (gjatesia totale 67.3 km), me fond limit 329,552,917 (treqind e njezet e nente milion e peseqind e pesëdhjete e dy mije e nenteqind e shtatembedhjete) Leke pa TVSh, me REF-10945-06-24-2024, dhe si i tille Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses i ngritur me urdher te Drejtorit te Pergjithshem per shqyrtimin e ankeses, shqyrton kete procedure prokurimi dhe jo procedura te tjera te cilat nuk jane plotesur ne Formularin e Ankesave dhe te cilat nuk jane objekte ankimi.

Per sa me siper, nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar nga bashkimi i operatoreve ekonomik “NDERTUESI 2014” sh.p.k & “VARAKU E” sh.p.k, per “Loti 2: Mirembajtje me performance ruga Koplik - Boge, Boge - Theth, Dedaj – Razem” jane plotesuar kriteret e kerkuara sipas pikes;

2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatoret ekonomike duhet të paragesin vërtetim per xhiron vietore per vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për te paktën një nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se vera e parashikuar e kontrates (vlera e fondit limit).

2.3.1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per sherbimet e meparshme të ngjashme, të kryera gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit te kontrates, ne nje vlere jo me te vogel se 30% të vlerës se fondit te limit te lotit perkates, realizuar me sukses gjate tri viteve te fundit...

2.3.4 Kandidati ofertues duhet te disponoje 1 (nje) Inxhinier Ndertimi, i cili do te jetë Drejtues Teknik i punimeve/sherbimeve, i perfshire ne licencën e shoqerise dhe te deklarojë se do të jete i pranishim gjate gjithë kohes qe do te kryhen sherbimet / punimet në objekt...

2.3.9 Operatori ekonomik pjesemarres per realizimin e kontrates, duhet te disponoje, mjetet dhe pajisjet sipas DST...

Bazuar ne formularin e vetdeklarimit te paraqitur per kete lot, bashkimi i operatorive ekonomik kane vetdeklaruar stafin dhe mjetet ne permbushje te kriterëve te cilat jane verifikuar edhe ne dokumentacionin e paraqitur fizikisht prane Autoritetit Kontraktor. Gjithashtu, ne dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik eshte plotesuar deklarate e cila mban datën 26.08.2024, mbi angazhimin e stafit dhe te mjeteve per proceduren me objekt: “Loti II - Mirembajtje me performance ruga Koplik-Boge, Boge-Theth, Dedaj-Razëm, me gjatesi 67.3 km”.

IV. Vendimi i komisionit te shqyrtimit te ankesës:

1. Komisioni i shqyrtimit te ankeses vendosi te mos pranoje ankesen e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik “Roku GUEST & DEHA 2010” shpk per proceduren me objekt: “Loti 2: Mirembajtje me performance rruga Koplik - Bogë, Boge - Theth, Dedaj - Razem (gjatesia totale 67.3 km), me fond limit 329,552,917 (treqind e njezet e nënte milion e peseqind e pesedhjetë e dy mije e nenteqind e shtatembedhjetë) Leke pa TVSh, me REF-10945-06-24-2024.

2. Vendimi i Komisionit te Shqyrtimit te Ofertave t'i behet me dije Komisionit te Prokurimit Publik.

II.11. Me shkresën nr. 2472/8 prot., datë 08.10.2024, me objekt “Mbi detyrimin e autotetit kontraktor për dhënie informacioni dhe dokumentacioni KPP-së lidhur me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK”, Komisioni Prokurimit Publik iu drejtuar autoritetit kontraktor Autoritetit Rrugor Shqiptar, duke i kërkuar informacion si mëposhtë vijon:

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike me nr. A/2024/4520, datë 04.09.2024, dhe me nr. 2472/2024 datë 04.09.2024, për procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-10945-06-24-2024, me objekt Lot 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km),”, me fond limit 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH, në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 20.08.2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; **b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar**; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi arsyet e skualifikimit dhe kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK ngren pretendime në ankesën nr. 2472 prot, datë 04.09.2024.

Referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “**Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.**

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar vetëm informacion dhe dokumentacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe akti i trajtimit të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues. Me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vetëm dokumentacionin e dorëzuar pranë jush nga bashkimi operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK në lidhje me vërtetueshmërinë e deklarimeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit shtojca 11, si dhe pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues në lidhje me arsyet e skualifikimit, ashtu sikurse përcaktohet në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Në Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 5 “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre; 55 b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit”.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së, brenda së nesërmes nga marrja dijeni.

II.12. Nëpërmjet shkresës me nr. 4211/21 prot., datë 15.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 2472/9 prot., datë 17.10.2024 me objekt “Dërgim dokumentacioni” ku citohet se “Në

vijim të shkresës tuaj nr. 2472/8 prot, datë 08.10.2024 “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni dhe dokumentacioni KPP-së lidhur me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK”, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Loti 2 Mirëmbajtje me performancë rruga Koplik – Bogë -, Bogë – Theth, Dedaj – Razëm” (gjatësia totale 67.3 km), me fond limit 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, me Numër Reference Ref-10945-06-24-2024, po ju dërgojmë dokumentacionin e njëhësuar me origjinalin, të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK se: “Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Rroku GUEST & DEHA 2010” K87921701H L03425410B Skualifikohet, pasi nuk përmbush, kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit. - Operatori ekonomik “Rroku GUEST” nuk përmbush kriterin 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë), si më poshtë: 1 (një) Inxhinier Topograf; 1 (një) Inxhinier Mekanik; Për secilin pjesëtar të stafit ndihmes të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Stafi i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese. KVO gjatë kontrollit të dokumentacionit të parqitur nga operatori ekonomik “Rroku GUEST” konstaton se, në dokumentat e paraqitura për Ing. Mekanik ka pasaktësi. Nisur nga ky konstatim KVO bëri verifikime dhe rezultoi se Inxhinieri Mekanik i deklaruar nga Operatori ekonomik “Rroku GUEST” është i punësuar në Institucion shtetëror me kohë të plotë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 10/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë), si më poshtë:

1 (një) inxhinier Topograf

1 (një) inxhinier Mekanik

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 11. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e pare, dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit ndihmes të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

❖ **Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.**

III.1.2. Në shtojcën 11 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 11

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----

Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet/ Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë

23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
☐
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo

angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

□

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose

Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; siguri; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

- Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:
• Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. • Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. • Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit**A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun	Po [] Jo []

ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	
---	--

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri_____ Firma _____ Vula_____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.1.3. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Kontratë Bashkimi i Përkohëshëm i Shoqërive “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK e datë 24.07.2024 lidhur midis “Rroku Guest” SHPK dhe “Deha 2010” SHPK. BOE “Rroku GUEST” sh.p.k. & “DEHA 2010” sh.p.k., bien dakord që të bashkojnë forcat dhe kompetencat e tyre në kuadrin e një bashkëpunimi të përkohshëm në një grup te vetëm (referuar më poshtë si “Grupi”). Ky bashkëpunim është ekskluziv dhe reciprok dhe secila palë merr përsipër konfidencialitetin e këtij bashkëpunimi si dhe mos bashkimin me asnjë palë tjetër të tretë. Shoqëria “Rroku GUEST” sh.p.k., do të veprojë si udhëheqëse dhe përfaqësuese e grupit kundrejt Autoriteti Kontraktor, duke kryer të gjitha veprimet në emër dhe për llogari të Bashkimit të Shoqërive (Grupit): Përfaqësuesi do të përfaqësojë Shoqërinë në lidhje me procedurën e shpallur nga Autoriteti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar për tenderin me objekt “Loti 2: Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)” Përfaqësuesi do të përfaqësojë bashkimin e operatoreve si në dorëzimin e kualifikimeve dhe të ofertës, e cila do të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi ka të drejtë gjithashtu të nënshkruajë dhe të depozitojë të gjitha aktet e nevojshme si dhe të ndjekë procedurat përkatëse pranë të gjitha autoriteteve publike, apo përpara personave të tretë fizikë apo juridikë, të nevojshme për realizimin e objektit të

prokurimit të sipërpërmendur, si në fazën para dhe gjatë zhvillimit të garës, ashtu edhe në atë pas saj. Përfaqësuesi ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme financiare me Autoritetin Kontraktor duke përfshirë pagesat sipas prokurës së posaçme. Për kryerjen e veprimeve të caktuara, Përfaqësuesi do të ketë të drejtën të autorizojë persona të tretë. BOE “Rroku GUEST” sh.p.k. & “DEHA 2010” sh.p.k., bashkojnë kapitalet, bilancet e tyre, makineritë, pajisjet, fuqinë punëtore, stafin teknik, e të tjera dhe janë përgjegjëse solidare për punimet e kryera, në mënyrë të veçante për zbatimin e kushteve të kontratës dhe të grafikut të punimeve dhe specifikimeve teknike. Pjesëmarrja në zbatimin e kontratës, do të jetë: Shoqëria “Rroku GUEST” sh.p.k. 94.3 % (Nëntëdhjetë e katër pikë tre për qind); Shoqëria “DEHA 2010” sh.p.k. 5.7 % (Pesë pikë shtatë për qind).

2- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Rroku Guest” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate”, operatori ekonomik “Rroku Guest” SHPK deklaroi:

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjës të nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [☒] Jo [☐] Nëse, po, numri i punonjësve: Mbi () punonjës. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:: 1. Z. _____, me profesion inxhinier ndertimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në profilin e transportit / infrastrukturës 2. Z. _____, me profesion inxhinier topograf, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit teknik për punimet gjeodezike; 3. Z. _____, me profesion inxhinier mekanik, punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e drejtuesit teknik për punimet e inxhinierisë mekanike. 4. Z. _____ me profesion inxhinier gjeolog, punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e drejtuesit për punimet gjeologjike. 5. Z. _____, me profesion inxhinier mjedisi, punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e drejtuesit për punimet mjedisore. <i>Vera Gege</i> 

	Z. _____ me profesion inxhinier ndertimi i cili disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar si dhe në zbatim të VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar me VKM Nr.562, Nr.563 dhe Nr.564, datë 3.07.2013 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës” . Z. _____ i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” 1. _____ me profesion manovrator / Eskavatorist 2. _____ me profesion manovrator / Eskavatorist 3. _____ me profesion manovrator / Eskavatorist 4. _____ me profesion manovrator / Eskavatorist 5. _____ me profesion manovrator / Automakinist 6. _____ me profesion manovrator / Automakinist 7. _____ me profesion manovrator / Automakinist 8. _____ me profesion manovrator / Buldozerist 9. _____ me profesion manovrator / Buldozerist 10. _____ me profesion manovrator / Buldozerist 11. _____ me profesion manovrator / Buldozerist Gjithashtu deklarojmë edhe punëtore të thjeshtë ndërtimi, për të cilët do të paraqesim kontratën e punës si dhe do të figurojnë në liste pagesë minimalisht të 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Makineri e mjete Po [☒] Jo [☐] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete
--	---

Data e dorëzimit të deklaratës 29.07.2024 Vula _____

Emri, Mbiemri, Firma

Verë GEGA

Verë Gega


3- Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se më datë 26.08.2024 BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK ka dorëzuar dokumentacion sipas kërkesës së ardhur në SPE nga autoriteti kontraktor. Dokumentacioni i dorëzuar nga BOE pranë autoritetit kontraktor është dërguar nga ky i fundit pranë KPP-së me shkresën nr. 4211/21 prot, datë 15.10.20245, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2472/9 prot, datë 17.10.2024, me objekt “Dërgim dokumentacioni”, nga verifikimi i të cilit rezulton se operatori ekonomik “Rroku Guest” SHPK në përmbushje të kriterit 2.3.5 për Inxhinierin Mekanik ka dorëzuar si më poshtë vijon:

- Kontratë individuale pune lidhur më datë 01.07.2024, midis shoqërisë “Rroku Guest” SHPK dhe z. H. D me profesion inxhinier mekanik, me afat të pacaktuar.
- Diplomë nr. xxx lëshuar nga Universiteti i Tiranës për z. I. D, i cili ka përfunduar Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike në degën Mekanike me titull Inxhinier Mekanik për Transport e Bujqësi.
- Cv.
- Librezë Pune.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.7. Neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *që operatorët ekonomikë të regjistruhen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
- c) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
- ç) *fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- d) *mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.8. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.1.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.***

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

- a) *operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) *operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*
- c) *personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese*

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve ¹të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shogëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në

njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe më datë 26.08.2024 dokumenta të cilat në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, si dhe kërkesës së bërë nga autoriteti kontraktor nëpërmjetë SPE më datë 21.08.2024, ku autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet, se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.** Referuar informacionit të autoritetit kontraktor nr. 6747/2 prot, datë 17.09.2024 rezulton se autoriteti i ka kërkuar dokumentat operatorit ekonomik ankimues nëpërmjetë SPE më datë

21.08.2024, dhe ky i fundit më datë 26.08.2024 ka dorëzuar pranë AK dokumentat në përmbushje të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nga verifikimi i të cilave rezultoi se autoriteti kontraktor “KVO gjatë kontrollit të dokumentacionit të parqitur nga operatori ekonomik “Rroku GUEST” konstaton se, në dokumentat e paraqitura për Ing. Mekanik ka pasaktësi. Nisur nga ky konstatim KVO bëri verifikime dhe rezultoi se Inxhinieri Mekanik i deklaruar nga Operatori ekonomik “Rroku GUEST” është i punësuar në Institucion shtetëror me kohë të plotë”. Duke u rikthyer tek pretendimi i operatorit ekonomik ankimes si dhe tek kriteri i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.5 të DST ku është kërkuar që **stafi i kërkuar në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.** Arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e autoritetit kontraktor nuk qëndron për faktin se në kriterin kualifikues autoriteti kontraktor ka kërkuar që stafi në pikën 2.3.5 Inxhinieri Topograf dhe Inxhinieri Mekanik nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese, dhe jo i dypunësuar në privat-shtet apo privat-privat, pra nga vetë verifikimi i kryer nga autoriteti kontraktor ka konstatuar se inxhinieri mekanik është i punësuar në institucion shtetërorë, por në lidhje me stafin mbështetës dypunësimin në referim të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” nuk është i ndaluar. Akoma më tej edhe neni 7 dhe 8 i ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” përcaktohet se neni 7 “Ndalimi i veprimtarive të jashtme”, “1. Nëpunësi publik nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, që pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare ose që kërkon një angazhim, mendor a fizik të tij që e bën të vështirë kryerjen e detyrës, ose është vazhdim i kësaj detyre, që cenon, në çfarëdo mënyre, imazhin e nëpunësit të administratës publike. 2. Në rast dyshimi për kualifikimin e një veprimtarie si të lejueshme ose jo, nëpunësi këshillohet me njësinë e personelit të institucionit. 3. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e klasifikimit të një veprimtarie të jashtme si të lejueshme ose jo”, neni 8 “Lejimi i veprimtarive të jashtme” “1. Kryerja e veprimtarive të jashtme duhet t’i njoftohet paraprakisht eprorit direkt të nëpunësit të administratës publike, dhe njësisë së personelit. 2. Veprimtaritë, në kuadër të veprimtarive sindikale ose të përfaqësimit të punëmarrësve ose veprimtaritë mësimdhënëse, janë të lejueshme kur ato nuk pengojnë në kryerjen e detyrës”. Aq më tepër që referuar kriterit për të cilin autoriteti kontraktor pretendon se nuk përmbushet nga operatori ekonomik “Rroku Guest” nuk ndodhemi përpara rastit klasik të ndalimit të dypunësimit sikurse parashikohet në kreun IV pika 1/c dhe 2 “Drejtuesi teknik dhe pajtueshmëria me këtë detyrë” të Vendimit Nr. 42 datë 16.01.2008 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullores për Kriteret dhe Procedurat e Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”, i ndryshuar ku përcaktohet në mënyrë eksplicite se: c) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës individuale të punës. 2. Pajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit, dhe në ligjislacionin sektorial i cili prevalon mbi ligjin e Prokurimit Publik.

Përkatësisht Ligji Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998, “*Për kontrollin dhe Disiplinimin e Punëve të ndërtimit*”, i ndryshuar, ku në nenin 8, Drejtuesi Teknik, pika 1 dhe 3, citohet “1.Drejtuesi teknik është solidarisht përgjegjës me zbatuesin e punimeve, për të realizuar punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. 3. Drejtuesi i punimeve është pjesë e stafit të zbatuesit të punimeve i përcaktuar në Licencën e shoqërisë”. Pra nga sa më sipër cituam rezulton se ligjvënësi kufizime në lidhje me angazhime në punëmarrje publike ka vendosur kufizime vetëm për drejtuesit teknik të shoqërive dhe jo për stafin mbështetës i cili nuk është i deklaruar në licensën e shoqërisë. Për rrjedhje, KPP gjykon se dokumentacioni i dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë në lidhje me kriterin e mësipërm e përmbush përsa i përketë disponimit të personelit 1 (një) inxhinier mekanik. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në procedurën e prokurimit për përmbushjen e kriterit 2.3.5, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*Rroku Guest*” SHPK & “*Deha 2010*” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Rroku Guest*” SHPK & “*Deha 2010*” SHPK se: “ *Operatori ekonomik “Rroku GUEST” në dokumentacionin e paraqitur për Borëpastruesen AJMT60, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se borëpastruesja nuk është APV sipas kërkesës në DST. Operatori ekonomik “Rroku GUEST” në dokumentacionin e paraqitur për Autobot uji, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se në lejen e qarkullimit është rimorkio për transport mallrash, foto e paraqitur nuk tregon që është Autobot Uji*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 10/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.9 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.9 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues mbi 8 ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Frezë asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Motomjet ose Agregatë për prerjen e bimësisë së ulët	në pronësi ose me qira	Copë 8
11	Kamionçinë deri në 3.5ton	në pronësi ose me qira	Copë 4
12	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Minifadromë (Bobcat ose ekuivalent)	në pronësi ose me qira	Copë 2
14	Ekskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 2
15	Makineri për vijëzim rrugor	në pronësi ose me qira	Copë 1
16	Mjet (Batipal) për vendosje parmakësh metalik (guardrails)	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Fabrikë Asfaltobetoni, e pajisur me QKL, leje mjedisore	pronësi /qira/ kontrate furnizim	Copë 1
18	Borëpastruese (APV) me freze + turbine + shnek për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Borëpastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)	në pronësi ose me qira	Copë 3

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës nr. 11. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, **si më poshtë:**

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; lejen e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore dhe fotot përkatëse;
- Ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- Për impiantin e asfaltit, të betonit duhet të paraqiten kontrata e blerjes apo zhdoganimit, fotot ose fatura tatimore përkatëse, lejen mjedisore lëshuar nga QKL. Nëse është marrë me qira/furnizim, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/furnizimit. Operatori ekonomik për fabrikën e asfaltit, të betonit mund të paraqesë edhe kontrata të vlefshme furnizimi me operatorë ekonomikë. Në këtë rast, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton ekzistencën dhe pronësinë e impiantit, si dhe lejen mjedisore kodi III.1.B lëshuar nga QKL.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruar ne procedura te shpallura fitues.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

III.1.2. Në shtojcën 11 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet/ Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

10. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;

11. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;

12. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

13. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;

14. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:

- c) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
- d) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

15. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;



- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).



16. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- e) çmimet ;
- f) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- g) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- h) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

17. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

18. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet

me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

- Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të

zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA "Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës"

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ Profili i punonjësve _____ _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____

Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	
--	--

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.3. Në përmbushje të kriterit më sipër cituar, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

1- Kontratë Bashkimi i Përkohëshëm i Shoqërive “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK e datë 24.07.2024 lidhur midis “Rroku Guest” SHPK dhe “Deha 2010” SHPK. BOE “Rroku GUEST” sh.p.k. & “DEHA 2010” sh.p.k., bien dakord që të bashkojnë forcat dhe kompetencat e tyre në kuadrin e një bashkëpunimi të përkohshëm në një grup te vetëm (referuar më poshtë si “Grupi”). Ky bashkëpunim është ekskluziv dhe reciprok dhe secila palë merr përsipër konfidencialitetin e këtij bashkëpunimi si dhe mos bashkimit me asnjë palë tjetër të tretë. Shoqëria “Rroku GUEST” sh.p.k., do të veprojë si udhëheqëse dhe përfaqësuese e grupit kundrejt Autoriteti Kontraktor, duke kryer të gjitha veprimet në emër dhe për llogari të Bashkimit të Shoqërive (Grupit): Përfaqësuesi do të përfaqësojë Shoqërinë në lidhje me procedurën e shpallur nga Autoriteti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar për tenderin me objekt “Loti 2: Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)” Përfaqësuesi do të përfaqësojë bashkimin e operatoreve si në dorëzimin e kualifikimeve dhe të ofertës, e cila do të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi ka të drejtë gjithashtu të nënshkruajë dhe të depozitojë të gjitha aktet e nevojshme si dhe të ndjekë procedurat përkatëse pranë të gjitha autoriteteve publike, apo përpara personave të tretë fizikë apo juridikë, të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit të sipërpërmendur, si në fazën para dhe gjatë zhvillimit të garës, ashtu edhe në atë pas saj. Përfaqësuesi ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme financiare me Autoritetin Kontraktor duke përfshirë pagesat sipas prokurës së posaçme. Për kryerjen e veprimeve të caktuara, Përfaqësuesi do të ketë të drejtën të autorizojë persona të tretë. BOE “Rroku GUEST” sh.p.k. & “DEHA 2010” sh.p.k., bashkojnë kapitalet, bilancet e tyre, makineritë, pajisjet, fuqinë punëtore, stafin teknik, e të tjera dhe janë përgjegjëse solidare për punimet e kryera, në mënyrë të veçante për zbatimin e kushteve të kontratës dhe të grafikut të punimeve dhe specifikimeve teknike. Pjesëmarrja në zbatimin e kontratës, do të jetë: Shoqëria “Rroku GUEST” sh.p.k. 94.3 % (Nëntëdhjetë e katër pikë tre për qind); Shoqëria “DEHA 2010” sh.p.k. 5.7 % (Pesë pikë shtatë për qind).

2- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit “Rroku Guest” SHPK. Në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**”, operatori ekonomik “Rroku Guest” SHPK deklaroi:

Deklarata	
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [☒] Jo [☐]

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta origjinalë ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [☒] Jo [☐] Nëse, po, numri i punonjësve: Mbi () punonjës. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:: 1. Z. , me profesion inxhinier ndërtimi, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në profilin e transportit / infrastrukturës 2. Z. , me profesion inxhinier topograf, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e drejtuesit teknik për punimet gjeodezike; 3. Z. , me profesion inxhinier mekanik, punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e drejtuesit teknik për punimet inxhinierse mekanike. 4. Z. , me profesion inxhinier gjeolog, punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e drejtuesit për punimet gjeologjike. 5. Z. , me profesion inxhinier mjedisi, punësuar pranë shoqërisë sonë në rolin e drejtuesit për punimet mjedisore.



“Rroku GUEST” Sh.p.k


“Rroku GUEST” Sh.p.k
ADRESA : Rr. Naimi Kryeziu, Nd 1/1, H 2, Ap. 8, Shkodër
 NPT-4 K 87921701 H
 Celular: +355682035500;
 E-mail : rrokuguest@gmail.com;

Z. , me profesion inxhinier ndërtimi i cili disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10/237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar si dhe në zbatim të VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” i ndryshuar me VKM Nr.562, Nr.563 dhe Nr.564, datë 3.07.2013 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës” . Z. Jetmir NIKOLLI i pajisur me certifikatë “Eksptert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” 1. me profesion manovrator / Eskavatorist 2. me profesion manovrator / Eskavatorist 3. me profesion manovrator / Eskavatorist 4. me profesion manovrator / Eskavatorist 5. me profesion manovrator / Automakinist 6. me profesion manovrator / Automakinist 7. me profesion manovrator / Automakinist 8. me profesion manovrator / Buldozerist 9. me profesion manovrator / Buldozerist 10. me profesion manovrator / Buldozerist 11. me profesion manovrator / Buldozerist Gjithashtu deklarojmë edhe punëtorë të thjeshtë ndërtimi, për të cilët do të paraqesim kontratën e punës si dhe do të figurojnë në listë pagesë minimalisht të 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Makineri e mjete Po [☒] Jo [☐] Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete	Data e dorëzimit të deklaratës 29.07.2024 Vula Emri, Mbiemri, Firma Verë GEGA 
---	---



"Rroku GUEST" Sh.p.k

ADRESA : Rr. Naimi Koyeshu, Nd 1/1, H 2, Ap.B, Shkodër
NPT-1 K 87921701 H
Celular: +355682035500;
E-mail : rrokuguest@gmail.com;

C: DEKLARATË "Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinierive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontratë"

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen në dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshtë

NË PRONËSI				
LLOJI I MJETIT	TARGA	NR. LEJES QARKULLIMIT	NR. SHASISË	TË TJERA
1. MJET TRANSPORTI VETËSHKARK. MBI 8 TON	AB AD	SHD0	WMAF02R232M	
2. MJET TRANSPORTI VETËSHKARK. MBI 8 TON	AA SH		WMAM081883Y	
3. MJET TRANSPORTI VETËSHKARK. MBI 8 TON	AA ME	SHD14	YV2F4B3G4VA	
4. MJET TRANSPORTI VETËSHKARK. MBI 8 TON	SH E	SHF02	WMAF094368M	
5. RRUL VIBRUES				
6. PRERËSE ASFALTI				
7. FREZË ASFALTI				
8. BETONIERE				
9. AUTOBOT UJI	AA FL	SHD 006	ZCFC357010	
10. AUTOBITUMATRICE	AA AF	SHF02	WDB6740421	
11. ASFALTOSHTRUESE				
12. MOTOMJET OSE AGREGATË PËR PRERJEN E DIMËSISË SË UJËT				
13. MINIESKAVATOR				
14. KAMIONCINË DERI 3.5TON	AA BF	SHF00	WDB67404215	
15. KAMIONCINË DERI 3.5TON	SH E	SHD05	31405112	
16. KAMIONCINË DERI 3.5TON	AB V	SHF01	318072145	
17. ESKAVATOR ME GOMA	ACMT	SHD02	117	
18. MAKINIERI PËR VIJEZIM RRUGOR				
19. MJET (BATIPAL) PËR VENDOSJE PARMAKËSH METALIK (GUARDRAILS)				
20. BORËPASTRUESE (APV) OSE AGREGATË PËR PASTRIM BORE ME KAMION NË DISPOZICION (KAMION+RRUSPË+SHPËRNDARËS KRIPE)	AJ SH	SHD09	WMAM081883Y	RRUSPA Fat. Nr. Dt: / /2020 SHPËRNDARËS KRIPE Fat. Nr. Dt: / /20
21. BORËPASTRUESE (APV) OSE AGREGATË PËR PASTRIM BORE ME KAMION NË DISPOZICION (KAMION+RRUSPË+SHPËRNDARËS KRIPE)	AA ZM	SHD08	WMAT040071M	RRUSPA Fat. Nr. Dt: / /2020 SHPËRNDARËS KRIPE Fat. Nr. Dt: / /20



"Rroku GUEST" Sh.p.k

ADRESA : Rr. Naimi Koyeshu, Nd 1/1, H 2, Ap.B, Shkodër
NPT-1 K 87921701 H
Celular: +355682035500;
E-mail : rrokuguest@gmail.com;

22. BORËPASTRUESE (APV) OSE AGREGATË PËR PASTRIM BORE ME KAMION NË DISPOZICION (KAMION+RRUSPË+SHPËRNDARËS KRIPE)	AJMT	SHD0001	WDB4081001W	MJET APV ME TE GJITHA PAJISJET SIPAS PËRSHKRIMIT NE D.S.T
23. KAMIONI NË DISPOZICION TE PAJISJEVE ME FREZE + SHNEK + TURBINE PËR PASTRIM DEBORE	AA KD	SHF059	443000	SHIKO TEK MJETET ME QIRA

ME QIRA					
Lloji i mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë	Afati i kontratës qerasë (data e fillimit dhe mbarimit)
* GREJDER	ALMT	SHF007	4XM	Nr. 650 /	ME OBJEKT PROKURIMI
* KAMIONCINË DERI 3.5 TON	AA UD	SHF028	WDB9036221R	Nr. 650 /	ME OBJEKT PROKURIMI
* MINI ESKAVATOR				Nr. 650 /	ME OBJEKT PROKURIMI
* Borëpastruese (APV) me freze + turbine + shnek për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)		Kontratë Shitblerjeje Me Nr. / 16, Me Numer Shasie KMTP0094U		Nr. 3412 / 1723	ME OBJEKT PROKURIMI
* ESKAVATOR ME GOMA	AGMT	TRDA14	JK6CCA0	Nr. 1216 /	ME OBJEKT PROKURIMI
* MINIFADROMË (BOBCAT OSE EKVIVALENT)	ADMT	TRDA41	CAT0272DPMD	Nr. 1216 /	ME OBJEKT PROKURIMI
* MINIFADROMË (BOBCAT OSE EKVIVALENT)	ADMT	TRDA41	CAT0272DKMD	Nr. 1216 /	ME OBJEKT PROKURIMI

Kontratë furnizimi			
Materiali/prodakti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit	Afati i kontratës furnizimit	Të tjera
* Fabrikë Asfaltobeton, e pajisur me QKL, leje mjedisore N, NUIS K	Nr. 3917 /	Data e fillimit 2022 Me afat vjeçar me të drejtë rinovimi	ME DOKUMENTACION SIPAS KËRKESAVE TË DST



3- Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se më datë 26.08.2024 BOE "Rroku Guest" SHPK & "Deha 2010" SHPK ka dorëzuar dokumentacion sipas kërkesës së ardhur në SPE nga autoriteti kontraktor. Dokumentacioni i dorëzuar nga BOE pranë autoritetit kontraktor është dërguar nga ky i fundit pranë KPP-së me shkresën nr. 4211/21

prot, datë 15.10.2024, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2472/9 prot, datë 17.10.2024, me objekt “Dërgim dokumentacioni”, nga verifikimi i të cilit rezulton se operatori ekonomik “Rroku Guest” SHPK në përmbushje të kriterit 2.3.9 për automjetet e kërkuar “Borëpastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)” dhe “Autobot uji” ka dorëzuar si më poshtë vijon:

- Referuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të dorëzuar nga ofertuesi “Rroku Guest” SHPK, në Pjesën III: “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, gërma “B”: “DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”, operatori ekonomik “Rroku Guest” SHPK deklaron se për automjetin “Borëpastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës kripe)” ka në pronësi automjetin me targë AJTMXX dhe për automjetin “Autobot uji” ka në pronësi automjetin me targë: AAXXXFL.

Për mjetin me targë AJTMXX, ka dorëzuar dokumentacionin e njëhsuar me origjinalin, si më poshtë vijon:

- Certifikatë pronësie nr: SHD000XXXXX, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër, ku vërtetohet se shoqëria “Rroku GUEST” SHPK ka në pronësi automjetin me targë: AJTMXX, me numër shasie: WDB4081001WXXXXXX, Marka: MERCEDES BENZ, Tipi: XXXX, Lloji, destinacioni dhe përdorimi: “Makinë teknologjike për zhbllokim rruge për operim mbi rrugë dhe kantiere.”.
- Leje qarkullimi nr: SHD000XXXXX, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër, ku vërtetohet se shoqëria “Rroku GUEST” SHPK ka në pronësi automjetin me targë: AJTMXX, me numër shasie: WDB4081001WXXXXXX, Marka: MERCEDES BENZ, Tipi: INIMOG, Lloji: “Makinë teknologjike për zhbllokim rruge”, Destinacioni dhe përdorimi: “Për operim mbi rrugë dhe kantiere – dhënie me qera pa drejtues mjeti.”, me masë maksimale të autorizuar (kg): 4800 dhe masë e mjetit bosh (kg): 3400.

Certifikatë e Kontrollit Teknik të Mjetit datë XX.XX.2024, e lëshuar Pika e Kontrollit Teknik të Mjeteve Shkodër, e lëshuar për automjetin “Makinë teknologjike për zhbllokim rruge”, me targë: AJMTXX, me numër shasie: WDB4081001WXXXXXX, me afat vlefshmërie deri në datë XX.XX.2025.

Policë sigurimi nr: XXXXXXXX, datë XX.XX.2024, lëshuar nga shoqëria e sigurimeve “XXXX” SHA, për automjetin me targë: AJMTXX, me numër shasie; WDB4081001WXXXXXX, në pronësi të shoqërisë “Rroku GUEST” SHPK, me afat vlefshmërie deri në datë XX.XX.2025.

Foto e mjetit.

Për mjetin me targë AAXXXFL, ka dorëzuar dokumentacionin e njëhsuar me origjinalin, si më poshtë vijon:

- Certifikatë pronësie nr: SHD00XXXXXX, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër, ku vërtetohet se shoqëria “Rroku GUEST” SHPK ka në pronësi automjetin me targë: AAXXXFL, me numër shasie: ZCFC357010XXXXXXX, Marka: XXXXX, Lloji, destinacioni dhe përdorimi: “Mjet për lagjen e rrugëve”.
- Leje qarkullimi nr: SHD00XXXXXX, e lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër, ku vërtetohet se shoqëria “Rroku GUEST” SHPK ka në pronësi automjetin me targë: AAXXXFL, me numër shasie: ZCFC357010XXXXXXX, Marka: XXXXX, Lloji: “ATP”, Destinacioni dhe përdorimi: “Përdorim vetjak”, me masë maksimale të autorizuar (kg): 3500 dhe masë e mjetit bosh (kg): 2700.
- Certifikatë e Kontrollit Teknik të Mjetit datë XX.XX.2024, e lëshuar Pika e Kontrollit Teknik të Mjeteve Shkodër, e lëshuar për automjetin “Automjet për transport të përzier”, me targë: AAXXXFL, me numër shasie: ZCFC357010XXXXXXX, me afat vlefshmërie deri në datë XX.XX.2025.
- Shkresë nr. 22654 prot, datë 30.12.2019, me objekt: “Kthim përgjigje kërkesës me Nr. Praktike 17204, datë 18.12.2019” e lëshuar nga Bashkia Shkodër për shoqërinë “Rroku GUEST” SHPK, ku ndër të tjera citohet, si në vijim: “Keni aplikuar për Certifikatë për Transport Mallrash për Llogari të Vetë brenda vendit, ME DATË 18.12.2019, ME NR. PRAKTIKE 17204. Nga kontrolli i dokumentacionit rezultoi se; Mjeti me targë AAXXXFL, ka kapacitet transportues 800 kg. Kërkesa juaj refuzohet; Mbështetur në Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, Kreu III.2 “Transporti i mallrave për vehte”, neni 46, ku thotë; ‘Dispozita e këtij ligji nuk zbatohet për mjetet me kapacitet transportues nën 1500 kg’.”.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet

kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.6. Në nenin 77, pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.7. Neni 39 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.8. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.9. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve³ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

³ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike⁴. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj

autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rruqë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.9 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe më datë 26.08.2024 dokumenta të cilat në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, si dhe kërkesës së bërë nga autoriteti kontraktor nëpërmjetë SPE më datë 21.08.2024, ku autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”,

“e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim, mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit për këtë procedurë prokurimi dhe përpara publikimit të njoftim-fituesit ka zbatuar përcaktimet e bëra në pikën 6 të nenit 26 të VKM, ku thuhet, se **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor nr. 6747/2 prot, datë 17.09.2024 rezulton se autoriteti i ka kërkuar dokumentat operatorit ekonomik ankimues nëpërmjetë SPE më datë 21.08.2024, dhe ky i fundit më datë 26.08.2024 ka dorëzuar pranë AK dokumentat në përmbushje të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nga verifikimi i të cilave rezulton se autoriteti kontraktor ka konkluduar si në vijim: “Operatori ekonomik “Rroku GUEST” në dokumentacionin e paraqitur për Borëpastruesen AJMT60, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se borëpastruesja nuk është APV sipas kërkesës në DST.

Operatori ekonomik “Rroku GUEST” në dokumentacionin e paraqitur për Autobot uji, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se në lejen e qarkullimit është rimorkio për transport mallrash, foto e paraqitur nuk tregon që është Autobot Uji.”. Duke u rikthyer tek pretendimi i operatorit ekonomik ankimues si dhe tek kriteri i përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.9 të DST ku është kërkuar që operatori ekonomik ofertues të disponojë 1 (një) automjet “Borëpastruese (APV) ose Agregatë për pastrim bore me kamion në dispozicion (kamion+rruspë+shpërndarës krije)” dhe 1 (një) automjet “Autobot uji”, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e autoritetit kontraktor nuk qëndron, pasi referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues “Rroku GUEST” SHPK dhe të listuar në pikën III.2.3 të këtij vendimi rezulton se automjeti më targë AJMT60 referuar destinacionit të përdorimit është automjet teknologjik që shërben për zhbllokimin e rrugëve dhe në këtë rast për largimin e dëborës nga rruga, ndërsa automjeti me targë AA572FL është automjet teknologjik që shërben për transport të përzierë dhe kryesisht për lagjen e rrugëve, duke plotësuar në këtë mënyrë qëllimin kryesor të vendosjes së këtij kriteri kualifikues, i cili është vërtetimi i kapaciteteve teknike lidhur me disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e shërbimit objeKT prokurimi, ku në rastin konkret është edhe shërbimi i pastrimit të rrugës nga dëbora dhe larja e rrugëve që do të mirëmbahen.

Lidhur me faktin që në lejet e qarkullimit të këtyre 2 (dy) mjeteve nuk është cilësuar lloji i automjetit “APV”, sikurse ka cilësuar autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues të sipërpërmendur, Komisioni gjykon se nga përshkrimi i destinacionit të përdorimit të këtyre mjeteve të bëra nga ana e autoritetit të ngarkuar me ligj dhe konkretisht nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër, rezulton se këto mjete janë automjete teknologjike dhe që kanë një destinacion përdorimi që përputhet me objektin e prokurimit,

pasi shërbejnë për realizimin e e dy shërbimeve objekt prokurimi, siç janë pastrimi i rrugëve nga dëbora dhe larja e rrugëve, duke e plotësuar kriterin kalifikues të përcaktuar në pikën 2.3.9 “Kapaciteti teknik” të Shtojcës 10/2 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor, ka detyrimin që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Akoma më tej, vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenet 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në procedurën e prokurimit për përmbushjen e kriterit 2.3.5, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK se “Duke patur autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën përshprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji” vlerësojmë që kualifikimi BOE “NDERTUESI 2014” shpk & “VARAKU E” sh.p.k është i pasaktë dhe se ky bashkim operatorësh ekonomik duhet skualifikuar pasi nuk ka plotësuar ofertën në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në D.S.T. Gjithashtu Referuar edhe Procesverbalit Nr. 2, Datë 20.08.2024 mbi

vlerësimin e ofertave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar (procesverbali do i bashkengjitet kërkesës) ku Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Rroku GUEST & DEHA 2010” K87921701H L03425410B Skualifikohet, pasi nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit. Operatori Ekonomik “Rroku GUEST” sh.p.k nuk përmbush kriteret kumulative referuar nën pikës 2.2.1 e seksionit 2.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit. “Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.” Referuar vërtetimit për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të deklaruar nga OE “Rroku GUEST”, ku vlera më e lartë e xhiros është viti 2023 me të ardhura 189,125,479 dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit “Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (nënpika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike, nënpika 2.3.1; 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5; 2.3.7 dhe 2.3.9 të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret.”, ku vlera e llogaritur që duhet të plotësojë operatori ekonomik duke marrë në konsideratë % e bashkëpunimit si dhe vlerën e fondit limit për lotet e përmendur në deklaratën kumulative është 272,773,161.10. Kriteri konsiderohet i papermbushur nga operatori ekonomik. Gjithashtu referuar edhe Dokumenteve Standarde të tenderit tek Njoftimi i Kontratës Pika 2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues: Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike - financiare (nënpika 2.2.1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike, nënpikat 2.3.1; 2.3.2; 2.3.3; 2.3.4; 2.3.5; 2.3.7 dhe 2.3.9 të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotësohet për kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar. Ne i kemi dërguar kërkesë Autoritetit Kontraktor për të na njoftuar për procedurat ku subjekti konkurues me ne ka ofertuar, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje për këtë kërkesë. Nisur nga kjo ne kemi marrë informacion nga operatorët e tjerë konkurues që OE “NDERTUESI 2014” ka ofertuar në lotet e mëposhtme: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me Nr. Reference REF-10943-06-24-2024 ; Loti 2: Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km) me Nr. Reference REF-10945-06-24-2024 ; Loti 3: Mirëmbajtje me performancë rruga “Harku i Bërdicës - Velipojë

(Vilun), Ura (Ere) e Bunës - Shirokë (fillim pedonalja), Baks - Rrjoll, K.Bushat - Bisht Jugë” (gjatësia totale 49.4 me Numër Reference REF-10947-06-24-2024. ; Loti 4: Mirëmbajtje me performancë rruga “D/Qafë Laç - Koman (Trageti), K/Vau i Dejës Nënshat (kufi me Lezhën)” (gjatësia totale 45.3 km) me Numër Reference REF-10949-06-24-2024. Operatori “NDERTUESI 2014” sh.p.k nuk plotëson pikën 2.2.1, në menyrë kumulative për të gjitha lotet sipas % që ka marrë përsipër në kontratat e bashkëpunimit, gjë që në këtë lot ka dështuar ta plotësojë duke mos paraqitur deklaratë ku ka listuar dokumentet e paraqitura (vertetim xhiro vjetore, dhe deklarate e përmbushjes kumulative per secilin lot) në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret duke e bërë jo legjitime kërkesën për ofertë të këtij BOE në këtë procedure, pra mendojmë qe kjo oferte duhet skualifikuar nga kjo procedurë për mosplotësim të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Operatori “NDERTUESI 2014” sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.1, në menyrë kumulative për të gjitha lotet sipas % që ka marrë përsipër në kontratat e bashkëpunimit sepse do duhej të kishte (sipas procesverbalit të argumentimit të kriterëve) shërbim të ngjashëm mirëmbajtje rutinë 173 044 920.24 lekë pa tvsh në total për të plotësuar në mënyrë kumulative për të gjitha lotet ku ka ofertuar, gjë që në këtë lot ka dështuar ta plotësojë duke mos paraqitur deklaratë ku ka listuar dokumentet e paraqitura (Deklaraten ku paraqet qe ka përmbushur vlerën totale te shërbimit te kerkuar) në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret duke e bërë jo legjitime kërkesën për ofertë të këtij BOE në këtë procedure, pra mendojmë qe kjo oferte duhet skualifikuar nga kjo procedurë për mosplotësim të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Operatori “NDERTUESI 2014” sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.4, në menyrë kumulative për të gjitha lotet sipas % që ka marrë përsipër në kontratat e bashkëpunimit sepse do duhej të plotësonte kriterin: “Kandidati ofertues duhet të disponoje 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, i cili do të jetë Drejtues Teknik i punimeve/shërbimeve, i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen shërbimet / punimet në objekt.”, duke qënë që ky bashkim operatorësh ka ofertuar në katër lote, pra duhet të ketë 4 inxhinierë ndërtimi në licencë, gjë që këto operatorë nuk e plotësojnë pasi këto kanë vetëm nga një inxhinier ndërtimi në licencë ku duhej të kishin katër inxhinierë , gjë që në këtë lot ka dështuar ta plotësojë duke mos paraqitur deklaratë ku ka listuar dokumentet e paraqitura (stafin teknik, 4 inxhinier ndërtimi drejtues teknik ne licence) në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret duke e bërë jo legjitime kërkesën për ofertë të këtij BOE në këtë procedure, pra mendojmë qe kjo oferte duhet skualifikuar nga kjo procedurë për mosplotësim të Dokumenteve Standarde të Tenderit. Operatori “NDERTUESI 2014” sh.p.k nuk plotëson pikën 2.3.9 në menyrë kumulative për të gjitha lotet sipas % që ka marrë përsipër në kontratat e bashkëpunimit, pasi janë kërkuar edhe mjetet në mënyrë kumulative si rrjedhojë ky operator ekonomik duhej të plotësonte një deklaratë për plotësimin e këtij numri makinerive sipas loteve ku ka ofertuar, sipas tabelës se mëposhtme(referuar D.S.T, kriteret e veçanta te kualifikimit), gje qe dyshojmë qe nuk e ka paraqitur, sipas kërkesës se DST. Gjithashtu operatori “NDERTUESI 2014” shpk nuk e ka plotësuar deklaratën ku të listohen dokumentet e paraqitura (makineritë, per secilin lot konkret) në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret, nuk ka zbatuar kriteret e vendosura në DST për këtë procedurë prokurimi duke e bërë jo legjitime kërkesën për ofertë të këtij BOE në këtë procedure, pra mendojmë qe kjo

oferte duhet skualifikuar nga kjo procedurë për mosplotësim të Dokumenteve Standarde të Tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren,

III.3.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues, (thema decidendum) në zbatim të nenit 118 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se: “ 2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, referuar parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit, referuar ankesës së dorëzuar njëherësh pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ka parashtruar pretendime në lidhje me mospërmbushjen e kriterëve të vecanta të kualifikimit në lotin e procedurës së prokurimit të ankimuar duke e lidhur këtë të fundin me kualifikimin e po të njëjtit operator ekonomik edhe në lotet e tjera të procedurës së prokurimit duke ngritur pretendime se ipso facto- fakti që operatori ekonomik është kualifikuar në lotet e tjera të procedurës së prokurimit nuk përmbush kriterin/et e vecanta të kualifikimit si vlerësim kumulativ i tyre në procedurën konkrete të prokurimit (ipso legge). Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues në lidhje me pretendimet e mësipërme të ndalet fillimisht në legjitimitimin e palës për kërkimin e mësipërm. Në nenin 94 pika 1, 2 dhe 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet se: “ 1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 2. Operatori ekonomik ankimues duhet të dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. 3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar. Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankimuesi duhet t’i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit,” Gjithashtu, ligjvënësi ka parashikuar edhe rregulla strikt mbi procedurën e shqyrtimit të ankesave si nga autoriteti

kontraktor ashtu edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik, në cilësinë e organit më të lartë të shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike, në zbatim edhe të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Kështu, ligjvënësi ka paraparë, se ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor bëhet kundrejt pagesës. Rregullat dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë, në nenin 1,2,3 dhe 4 të Vendimit nr. 236 datë 20.04.2023 të Këshillit të Ministrave “Për Përcaktimin e Rregullave dhe Tarifës së Pagesës për Ankimin në një Procedurë Prokurimi Pranë Komisionit Të Prokurimit Publik”, parashikohet se: “ 1. Ankesa e paraqitur pranë autoritetit ose entit kontraktor, si dhe Komisionit të Prokurimit Publik, sipas parashikimeve të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, nga çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, duhet të përmbajë bashkëlidhur dokumentin bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. 2. Për shqyrtimin e ankesës, operatori ekonomik ankimues detyrohet të paguajë pranë Komisionit të Prokurimit Publik tarifën, sipas përcaktimeve të mëposhtme: a) Kur ankesa paraqitet për dokumentet e tenderit, 0.4% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohet; b) Kur ankesa paraqitet për vendimin e vlerësimit, klasifikimit përfundimtar ose vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, 0.5% të vlerës së procedurës së prokurimit që ankimohet; c) Kur ankesa paraqitet për pavlefshmërinë e kontratës, 0.5% të vlerës së kontratës së nënshkruar. 3. Parapagimi i tarifës nga operatori ekonomik ankimues ose operatori ekonomik i interesuar është kusht i domosdoshëm për pranimin dhe shqyrtimin e ankesës. Në rastet e moskryerjes së pagesës, autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik i lind e drejta e mospranimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues ose operatori ekonomik i interesuar.”. Në Vendimin nr. 766/2021, datë 13.10.2021 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet shprehimisht se: Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës. 2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme: a) Të dhënat identifikuese të ankimuesit; b) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi c) Bazën ligjore; d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar; e) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka; f) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën; g) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar. 3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni; b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtarit të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun; c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

III.3.2. Referuar procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP konstaton se kjo procedurë prokurimi është e ndarë në lotë dhe vetë operatori ekonomik ankimues parashtron pretendime

në lidhje me përmbushjen e kriterëve të kualifikimit nga bashkimi I operatorëve ekonomikë “Ndërtimi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK referuar loteve ku ky i fundit ka marrë pjesë.

III.3.3. Neni 42 i Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit.

Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

4. Autoriteti/enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose, kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa, ose për të gjitha lotet.

5. Autoriteti/enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t’i jepen një ofertuesi, me kusht që numri maksimal i loteve për ofertues të deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

7. Kur të njëjtit ofertues mund t’i jepet më shumë se një lot, autoriteti/enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, vetëm nëse ka specifikuar më parë, në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi, mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

8. Autoriteti/enti kontraktor mund të përcaktojë kërkesat minimale që u kërkojnë operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

9. Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës.

III.3.4. KPP vëren se ankimesi në parashtrimet në ankesë kundërshton kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtimi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK me argumentat se nuk plotëson kushtet kumulative për të gjitha lotet. Ndërkohë KPP vëren se ankesa e operatorit ekonomik ankimesi i referohet vetëm lotit 2 me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “*Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)*”, me fond limit totale **329,552,917** (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH”, dhe rrjedhimisht ankimesi ka paguar tarifën e ankesës vetëm për lotin 2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se neni 109 e në vijim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 94 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë në KPP, në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje KPP.

Procedura përpara KPP ka natyrën e procedurave të nxitura (lat.-jurisdicion voluntari) pasi KPP nuk mund të bëhet vetiniciatore e fillimit të procedurave (ex officio). Si rregull, investimi i KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara. KPP sqaron Interesi në gjykim përcakton edhe pozitën procedurale të palëve në proces. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se e drejta ligjore e subjektit për parashtrimin e një pretendimi para Komisionit të Prokurimit Publik për mborjtjen e një interesi të caktuar që njihet si legjitimimi, së bashku me cështjen e kompetencës lëndore të organit administrativ njihet që specifikohen ndryshe edhe si “objekti i ankesës” në Vendimin nr.766/2021, datë 13.10.2021 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik) si edhe kushti i shterimit të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor (neni 10 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 94 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar) janë kriteret përcaktuese për të filluar edhe një shqyrtim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP konstaton se operatori ekonomik ankimesi ka parashtruar pretendime në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtimi 2014” shpk & “Deha 2010” shpk duke e lidhur këtë të fundit me ligjshmërinë e veprimeve (kualifikimin/skualifikimin) nga lote të tjera të procedurës së prokurimit, për të cilat, operatori ekonomik ankimesi nuk ka shteruar rrugën e ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në respekt të nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 94 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar. Kështu, KPP konstaton se operatori ekonomik me anë të ankesës së tij për lotin e procedurës së prokurimit objekt ankimi ka kërkuar kryerjen e rishikimit administrativ referuar loteve të tjera të procedurës së prokurimit për të cilat nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet formale të paraqitjes së ankesës. Në nenin 42 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “ “Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta

brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedure”. Në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar qartësisht se fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër duke e paraparë si procedurë të vecantë brenda një procedure. Në rastin konkret, që ankimesi të gëzojë lëgjitimet aktiv si edhe legjitimitet të vërë në lëvizje Komisionin e Prokurimit Publik (lat- locus standi) të shqyrtojë dhe vlerësojë dokumentacionin e paraqitur nga operatorë të tjerë ekonomikë në lote të tjera të procedurës së prokurimit do të duhej që ankimesi të kishte ezauruar ankim administrativ edhe për lotet në të cilat ngre pretendime. Në të kundërt, Komisioni i Prokurimit Publik nuk gëzon kompetenca lëndore të shqyrtimit të ligjshmërisë së veprimeve (kualifikimit/skualifikimit) të operatorëve të tjerë ekonomikë, megjithëse ankesa është e lidhur me lotin konkret, në lote për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit e për rrjedhojë KPP nuk ka ushtruar të drejtën e tij ligjore të shprehet si me vendime të ndërmjetme për pezullimin e procedurës dhe /ose kërkimin e informacionit si edhe me vendim përfundimtar mbi themelin e çështjes. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të sqarojë se ky i fundit është paraparë nga ligjvënësi si një organ “sui generis”, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, quasi gjykatë, e pranuar edhe nga Gjykata Kushtetuese. Në rastin konkret, ankesa në KPP dhe rishikimi administrativ i procedurës së prokurimit kushtëzohet nga dy komponentë bazë, ai i ndjekjes së rrugës së ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe i kryerjes së veprimeve procedurale (pagimit të tarifës) si shkak për nisjen e shqyrtimit administrativ. Sa më sipër, KPP gjykon se kjo e fundit nuk mund të shqyrtojë dhe vlerësojë mbi dokumentacione të dorëzuara në lote të tjera të procedurës së prokurimit në kushtet për faj të ankimesit ky i fundit nuk ka ezauruar ankimin administrativ në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për lotet e mësipërme që pretendon.

Sa më sipër KPP gjykon se nuk mund të marrë në shqyrtim pretendimet e sipërcituara të ankimesit për pretendime që lidhen me përmbushjen e kushteve kumulative për të gjitha lotet.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK në lidhje me skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK nga procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK si dhe të korrigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri